



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 688/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Adelina Ukaj nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Deçan, për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Adelina Ukaj nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Deçan.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.11.2013, nga Adelina Ukaj nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Deçan, në të cilën pretendohet se pas marrjes së rezultateve zyrtare nga KQZ -ja në Prishtinë për komunën e Deçanit shprehi pakënaqësi për këto Qendra të Vendvotimit me nr.0101C, VV nr.0102C, VVnr.0106C, andaj kërkoj nga ju rinumërimin e votave, këtë e bazoj edhe në një dëshmi në QV nr.0101C në klasën V ka votu nëna ime me asistent për një plake ndërsa në rezultatet nuk figuron vota. Dyshimet janë të bazuara dhe atë brenda subjektit tim politik, thuhet në pretendimet e ankuesit.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një



vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve te vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrori ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshtënuar dhe në kuptim te nenit 118.1 te LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat te cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund ti hidh poshtë (si te palejuar, të parregullta apo te pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat te cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e dukura ligjore”, vendosi si ne dispozitiv te ketij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 688/2013 më datën 08.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.